



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbajtur, më 14.01.2020)*

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimeve:

- “Për shfuqizimin e pezullimit të procedurës së komandimit për pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin”;
- “Për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në njësinë e vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve në këshillin e lartë gjyqësor”.
- “Për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në njësinë e vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve në këshillin e lartë gjyqësor”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:35 dhe mbaroi në orën 10:02.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ilir Toska*** (anëtar)

8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Helena Papa, Drejtoresh pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
5. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
6. *Elsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
7. *Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
8. *Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
9. *Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
10. *Vjollca Kola, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
11. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
12. *Gregor Borkowski, EURALIUS.*
13. *Anisa Kuqi, EURALIUS.*
14. *Valbona Bala, USAID.*
15. *Arlind Maloku, QE.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimeve:

- “Për shfuqizimin e pezullimit të procedurës së komandimit për pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin”;
- “Për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në njësinë e vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve në këshillin e lartë gjyqësor”.
- “Për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në njësinë e vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve në këshillin e lartë gjyqësor”.

**Naureda Llagami:** Siç jeni vënë në dijeni, sot po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 14.01.2019 (*lapsus, 2020*).

Sipas rendit të ditës sot kemi dy çështje për të marrë në shqyrtim.

Çështja e parë ka të bëjë me komandimin e dy gjyqtareve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe çështja e dytë ka të bëjë me shpalljen e vendeve të lira për gjyqtarët e emëruar me datë 09.01.2020.

Atëherë le të fillojmë pa humbur kohë në lidhje me relatimin e çështjes së parë, e cila janë tre projekt-akte që do të relatohen nga zonja Brikena Ukperaj.

**Brikena Ukperaj:** Faleminderit, zonja Kryetare!

Sikundër jeni në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 104 të datës 05.07.2019 ka shpallur hapjen e procedurës së komandimit për 4 pozicione, 2 pozicione “këshilltar ligjor” në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Këshillit dhe 2 pozicione “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve.

Nga katër këto pozicione Këshilli ka përfunduar procedurat e komandimit për dy pozicionet e shpallura në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve dhe me vendimin nr. 205 të datës 11.10.2019, me vendim të ndërmjetëm, ka pezulluar procedurën e komandimit për dy pozicionet e shpallura “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” deri në përfundim të shqyrtimit të statusit të inspektorëve dhe përbërjes së Njësisë së Vlerësimit Profesional dhe Etik në KLGJ.

Në vijim Këshilli ka përfunduar shqyrtimin e statusit të ish-inspektorëve, me përjashtim të zonjës {...} për të cilën ka pezulluar procedurën në pritje të vendimmarrjes së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ndërkohë që zonja {...} është dekretuar si anëtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe nuk është më pjesë e strukturës së Njesisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve. Sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë KLGJ-së, Njësia e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve ka një organikë të miratuar 6+1 nga e cila aktualisht ka vetëm një vend vakant. Veç këtij të fundit, një pozicion tjetër brenda kësaj strukture është e pritshme që të mbetet vakant për shkak të kërkesës për heqje dorë nga detyra të magjistratit {...} i cili ka qenë gjyqtar i komanduar në pozicionin e ish inspektorit, kërkesë e paraqitur prej tij në datën 08.01.2020 dhe që në zbatimin e nenit 65 pika 2 të ligjit për Statusin do t'i japë efektet, pra e pritshme është që të japë efektet në fund të muajit shkurt 2020.

Plotësimi i strukturës së Njesisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve është prioritet për Këshillin, jo vetëm për shkak të angazhimeve që ka kjo strukturë në procesin e vlerësimit, me përgatitjen e raporteve ndihmëse për organet e vlerësimit lidhur me aftësitë profesionale të gjyqtarëve, por dhe për shkakun se kjo strukturë do të mbështesë Komisionin e Vlerësimit Etik dhe Profesional në realizimin e procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve sipas një programi që vetë KLGJ ka miratuar për vitin 2020.

Në kushtet e mësipërme ku shkakun për të cilin Këshilli ka vendosur pezullimin e procedurës së komandimit për dy pozicionet e shpallura “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” ka rënë dhe aktualisht brenda Njesisë së Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve ka një vend vakant dhe një tjetër që pritet të mbetet i tillë që prej fillimit të marsit 2020, vijimi i procedurave të komandimit për dy pozicionet e shpallura brenda kësaj njësie është i domosdoshëm. Kjo domosdoshmëri diktohet nga nevoja për të siguruar në kohë funksionalitetin dhe kapacitetet e plota njerëzore të kësaj Njësie, prandaj Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale i propozon mbledhjes plenare në zbatim të neneve 61 dhe 97, pika 3 të ligjit 115 të vitit 2016, pikës 5 nenit 64 të ligjit 96 të vitit 2016, neneve 11, 67 dhe 68 pika 2 të Kodit të procedurave administrative, në kushtet kur KLGJ ka në rastin konkret edhe cilësinë e institucionit ku

kërkohe të kryhet komandimi, shfuqizimin e procedurës së komandimit për dy pozicionet e shpallura “nëpunës përgjegjës për vlerësimin”.

Në varësi pastaj të kësaj vendimmarrjeje do të vijohet me relatimin e pjesës tjetër të projekt-akteve të përgatitura nga Komisioni.

**Naureda Llagami:** Atëherë, në qoftë se nuk kemi ndonjë diskutim lidhur me propozimin e bërë nga relatorja, kalojmë në shqyrtimin e projekt-akti të parë që ka të bëjë me shfuqizimin e pezullimit të procedurës së komandimit për pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin”, sipas propozimit të bërë nga relatorja.

Maksi, kalojmë në votim?

*(Vota e zotit Qoku nuk dëgjohet.)*

*(Vota e zonjës Kadi nuk dëgjohet.)*

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi shfuqizimin e pezullimit të procedurës të komandimit për dy pozicionet të shpallura “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e dytë që do relatohet sërish nga zonja Ukperaj.

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, në kushtet kur efektet e shfuqizimit të pezullimit janë të menjëhershme, në vijim po ju paraqiten të dhëna në lidhje me vlerësimin, renditjen dhe propozimet për komandim për kandidatët që kanë aplikuar për pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” dhe që janë dy gjyqtaret {...} dhe {...}.

Për të dyja këto gjyqtare rikujtojmë që gjatë fazës së parë të verifikimit, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, mbledhja plenare ka konstatuar mungesën e kriterëve ndaluese dhe ka vlerësuar se komandimi i secilës prej tyre nuk dëmtonte apo nuk cenonte funksionalitetin e gjykatave respektive.

Në fazën e dytë procedura e komandimit ka vijuar me vlerësimin e kriterëve të komandimit. Ky vlerësim është bërë në përputhje me vendimin nr.104 të datës 05.07.2019 nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Profesional. Vlerësimi është bërë mbi baza dokumentare bazuar në të dhënat e dosjes personale dhe dokumentacionit të depozituar rishtazi në KLGJ, bashkëngjitur kërkesës për komandim pa u vlerësuar i nevojshëm intervistimi.

Gjatë procedurës së vlerësimit Komisioni ka patur parasysh kriteret preferenciale të parashikuara në vendimin nr.104 të datës 05.07.2019 sipas të cilit ka përparësi kandidati që plotëson këto kriterë: ka ekspertizë të veçantë në fushën e hartimit të akteve rregullatorë; ka njohuri mbi legjislacionin e vendeve të Bashkimit Evropian, mbi aktet ndërkombëtare dhe mbi jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemit gjyqësor; është autor i artikujve ose botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës; ka njohuri të mira të paktën në një gjuhë të Bashkimit Evropian; ka aftësi të mira profesionale, organizative dhe personale si dhe etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale.

Gjyqtarja {...} e cila është aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, ka një eksperiencë pune prej 6 vjetësh, sot që ne e marrim në shqyrtim kërkesën, dhe ka gjykuar në shkallë të parë të gjitha kategoritë e çështjeve gjyqësore veç atyre administrative. Ka njohuri shumë të mira të gjuhës angleze dhe asaj italiane. Nga pesë dokumentet ligjore të paraqitur prej saj konkludohet se ka aftësi shumë të mira profesionale. Në çdo dokument ligjor, gjyqtarja i referohet pretendimeve dhe të dhënave që janë shqyrtuar gjatë procesit, përmend dhe analizon bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes dhe analizohen provat në drejtim të saj. Të pesë dokumentet ligjore janë të rregullt në formë dhe të qartë në përmbajtje. Pjesët e vendimit kanë lidhje dhe janë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës, duke respektuar rregullat e një mendimit të drejtë.

Nuk gjen në pjesën arsyetuese kundërthënie argumentesh apo mospërputhje me pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parime dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë logjik.

Nisur nga mënyra e arsyetimit të dokumenteve ligjore, pavarësisht se nga ana e Komisionit nuk është bërë vlerësim i dosjeve konkrete, por dhe nga koha që paraqitet në fakt referuar vendimeve e shqyrtimit të çështjes, konstatohet që gjyqtarja ka aftësi të mira organizative. Është ndjekëse e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës dhe atyre të organizuar nga organizata të tjera ndërkombëtare, çka tregon që ajo ka angazhim ndaj vlerave të saj profesionale.

Ka eksperiencën të tjera personale sepse në periudhën 01.02.2007-18.10.2009 ka punuar si specialiste pranë Zyrës Rajonale të Punësimit Vlorë, ndërkohë që për të njëjtën periudhë ka dhënë asistencë juridike si trajnuese në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga gjyqtarja, nuk rezultojnë të dhëna mbi ekspertizën të veçanta në fushën e hartimit të akteve rregullatore, njohuri mbi legjislacione të vendeve të Bashkimit Evropian, mbi akte ndërkombëtare dhe mbi jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemit gjyqësor, referuar pikave /a/ dhe /b/ të nenit 5 të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Nga ana tjetër, nuk rezulton që ajo të jetë autore apo bashkautore në ndonjë artikull apo botim shkencor në fushën e jurisprudencës.

Lidhur me gjyqtaren {...} që është aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ajo ka një eksperiencë aktuale prej 3 vjet e 6 muaj dhe ka gjykuar të gjitha kategoritë e çështjeve gjyqësore. Ka njohuri shumë të mira të gjuhës angleze dhe asaj italiane. Është autore e artikullit shkencor me temë: “Paradigma moderne e drejtësisë penale: Drejtësia restauruese”, botuar nga Qendra Evropiane kërkimore, trajnuese dhe zhvillimore në Mbretërinë e Bashkuar. Nga pesë dokumentet ligjore të paraqitur prej saj konkludohet se ka aftësi shumë të mira profesionale.

Në vendime gjyqtarja i referohet pretendimeve dhe të dhënave që janë shqyrtuar gjatë procesit gjyqësor, përmend dhe analizon bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes dhe analizohen provat në drejtim të saj. Dokumentet janë të rregullt në formë dhe të qartë në përmbajtje. Pjesët e dokumentit kanë lidhje dhe janë në shërbim

dhe funksion të njëra-tjetrës, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Nuk ka kundërthënie argumetash në vendim, ndërkohë që konkluzionet e pjesës arsyetuese bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parime dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik.

Edhe për këtë gjyqtare, nisur nga mënyra e arsyetimit të dokumenteve dhe koha e shqyrtimit të çështjeve, për të cilat janë paraqitur vendimet gjyqësore, konkludohet sa ka aftësi të mira organizative. Është ndjekëse e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës dhe atyre të organizuara nga organizata të tjera ndërkombëtare, çka tregon se ka angazhim ndaj vlerave të saj profesionale.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga gjyqtarja, nuk rezultojnë as për këtë gjyqtare të dhëna mbi ekspertiza të veçanta në fushën e hartimit të akteve rregullatore, njohuri mbi legjislacione të vendeve të Bashkimit Evropian, mbi jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemit gjyqësor, sipas kriterëve të vendosur në pikën a dhe b të nenit 5 të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që ishin për sa i përket kriterëve në fakt preferenciale.

Bazuar sa më lart, Komisioni ka vlerësuar se të dy gjyqtaret shfaqin aftësi të mira profesionale, organizative dhe personale, si dhe etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale dhe zotërojnë shumë mirë gjuhën angleze dhe atë italiane.

Pavarësisht se nuk kanë eksperiencë personale në draftimin e akteve rregullatore, për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit por edhe të veprimtarive të tjera jashtë këtij funksioni, shfaqin aftësi interpretuese dhe zbatuese të ligjit dhe aftësi teknike për kërkime ligjore mbi legjislacionin e vendeve të Bashkimit Evropian, akte ndërkombëtare, jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemit gjyqësor.

Nga ana tjetër, referuar kriterëve preferencialë të parashikuar në pikën 5 të vendimit, nuk është vlerësuar e nevojshme nga ana e Komisionit që të bëhet një renditje e tyre, pasi në rastin konkret pozicionet e shpallura për komandim janë 2 dhe të dy gjyqtarët plotësojnë kushtet dhe kriteret e komandimit.

Për sa i përket fillimit të efekteve të komandimit, për të dy gjyqtaret, fillimi i



efekteve do të jetë i ndryshëm, në kushtet kur një nga dy pozicionet e shpallura pritet që të jetë i lirë që prej datës 02.03.2020.

Përzgjedhja e gjyqtarëve në lidhje me fillimin e komandimit propozohet të bëhet mbi bazën e ngarkesës në punë të secilës prej tyre. Sipas informacionit të dërguar elektronikisht, gjyqtarja {...} ka një ngarkesë pune prej 95 çështje, e cila është afërsisht sa ngarkesa mesatare aktuale për gjyqtar në atë gjykatë, ndërsa gjyqtarja {...} ka një ngarkesë pune prej 157 çështje, ndërkohë që ngarkesa mesatare e gjyqtarëve të dhomës civile ku ajo gjykon në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë është 137 çështje. Në këto kushte propozohet që për gjyqtaren {...} komandimi të fillojë më parë, ndërsa për gjyqtaren që ka ngarkesën më të madhe të çështjeve, znj. {...} të fillojë në datë 02.03.2020, periudhë gjatë së cilës kjo e fundit duhet të përjashtohet vetëm nga shortimi i çështjeve të reja por jo çështjeve urgjente sepse çështjet urgjente janë me afat të shkurtër dhe duke qenë se koha është relativisht një muaj e gjysmë, ajo mund t'i shqyrtojë.

Sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbledhjes plenare, konkretisht:

Komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Afati i komandimit është 2 vjet. Kjo periudhë komandimi propozohet të fillohet në datë 21.01.2020, me qëllim lënien e një afati të arsyeshëm për dorëzimin prej saj të dosjeve apo për përfundimin e gjykimeve të çështjeve për të cilat është mbyllur shqyrtimi gjyqësor. Komisioni propozon gjithashtu, që deri në fillimin e periudhës së komandimit, gjyqtarja duhet të përjashtohet nga procedurat e ndarjes së çështjeve me short në gjykatë.

Propozimi i dytë lidhet me komandimin e gjyqtarës {...} dhe për të cilën edhe për këtë gjyqtare propozohet komandimi në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Afati i komandimit është 2 vjet. Kjo periudhë komandimi propozohet të fillohet në datë 02.03.2020, marrë shkas që efektet e dorëheqjes së zotit {...} do të fillojnë në fund të muajit shkurt të vitit 2020. Komisioni propozon gjithashtu, që deri në fillimin e periudhës së komandimit, gjyqtarja duhet të përjashtohet nga procedurat e ndarjes së çështjeve me short në gjykatë, me përjashtim të “çështjeve urgjente”. Ky ishte dhe relatimi për të dyja

projekt-aktet se është e njëjta procedurë administrative verifikimi.

**Naureda Llagami:** Atëherë, keni ndonjë diskutim përpara se të kalojmë në vlerësimin dhe miratimin e projekt-akteve të propozuar nga Komisioni?

Atëherë, kalojmë në propozimin e projekt-aktit të parë?

Atëherë, nga ana e Komisionit propozohet që komandimi i gjyqtares {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e vlerësimit Profesional dhe Etik të gjyqtarëve. Periudha e komandimit është 2 vjet dhe fillon me datë 21.01.2020. Përrjashtimi i menjëhershëm i gjyqtares {...} nga procedura e ndarjes së çështjeve gjyqësore me short në gjykatë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në votim?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, kalojmë në propozimin e dytë, i cili është komandimi i gjyqtares {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të gjyqtarëve. Periudha e komandimit është 2 vjet dhe fillon në datë 02.03.2020. Përrjashtimin e menjëhershëm të gjyqtares {...} nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore me short në gjykatë me përjashtim të çështjeve urgjente. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Votim?

**Maksim Qoku:** Dakord.

*Brunilda Kadi*: Dakord.  
*Dritan Hallunaj*: Pro.  
*Irir Toska*: Dakord.  
*Alban Toro*: Dakord.  
*Fatmira Luli*: Pro.  
*Marçela Shehu*: Dakord.  
*Erjon Muharremaj*: Pro.  
*Brikena Ukperaj*: Pro.  
*Medi Bici*: Pro.  
*Naureda Llagami*: Dakord.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 14.01.2020)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e vendeve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 09.01.2020”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:35 dhe mbaroi në orën 10:02.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>         | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>11. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b>         |

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
5. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
6. *Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
7. *Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
8. *Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
9. *Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
10. *Vjollca Kola, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
11. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
12. *Gregor Borkowski, EURALIUS.*
13. *Anisa Kuqi, EURALIUS.*
14. *Valbona Bala, USAID.*
15. *Arlind Maloku, QE.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e vendeve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 09.01.2020”.

*Naureda Llagami:* Atëherë, kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shpalljen e vendeve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 09.01.2020, projekt-akt i cili është përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Fjalën ia jap zotit Toska.

**Ilir Toska:** Faleminderit! Atëherë sikurse jeni në dijeni Këshilli i Lartë Gjyqësor pasi përfundoi procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin si gjyqtar të kandidatëve për magjistratë profili gjyqtar të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019, në mbledhjen e datën 9 janar 2020 bëri emërimin e tyre si gjyqtar, mbështetur në nenin 35 të ligjit nr.96 të vitit 2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ndërkohë në ushtrim të përgjegjësisë dhe të funksionit të përcaktuar në nenet 147 pika 1 dhe nenin 147/a pika 1, shkronja “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 39 pika 1 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të shpallë pozicionet e lira për gjyqtarët e emëruar në datë 9 janar 2020 ku për këtë qëllim është përgatitur edhe projektvendimi përkatës, në pikën 1 të të cilit përcaktohet pikërisht një gjë e tillë. Në këtë rast është mbajtur në konsideratë përcaktimi i bërë në nenin 25 pika 1 të ligjit nr. 48/2019 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.96 të vitit 2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit, deri në miratimin nga këshillat të akteve nënligjore për vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve të realizimit të procedurave të vlerësimit sipas këtij ligji, por jo më vonë se afati i caktuar për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve, emërimi i kandidatëve të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, që sipas ligjit është parësor, nuk do të ndërvohet nga përfundimi i procedurave të transferimit paralel dhe/ose të ngritjes në detyrë për magjistratët.

Pra pavarësisht se sipas nenit 39 pika 1 të ligjit në fjalë pozicionet e lira për të emëruarit duhet të shpallen pas përfundimit të procedurave të transferimit paralel dhe ngritjes në detyrë, ndërsa aktualisht jemi në regjimin e dispozitës kalimtare, Këshilli mund dhe duhet të shpallë pozicionet e lira për të emëruarit në datën 9 janar 2020 pa kryer më parë lëvizjet paralele të ngritjes në detyrë.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohen pozicionet e lira në gjykatat përkatëse të cilat shpallen për të emëruarit në datë 9 janar 2020 konkretisht 2 pozicione në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër, 2 pozicione në Gjykatën Administrative të

Shkallës së Parë Korçë, 2 pozicione në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, 1 pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, 1 pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, 1 pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, 1 pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, 1 pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, 1 pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, 1 pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, 1 pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe 1 pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në total sipas pikës 2 të projektvendimit parashikohet shpallja e 15 pozicione të lira. Lidhur me përcaktimin e një numri të tillë është mbajtur në konsideratë përcaktimi i bërë në nenin 25 pika 2 të ligjit nr.48 të vitit 2019 sipas të cilit për shpalljen e pozicioneve të lira për kandidatëve për magistratë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në çdo rast Këshillat vlerësojnë mbarëvajtjen e sistemit të drejtësisë dhe në veçanti nevojat urgjente të gjykatave dhe prokurorive në këndvështrim të funksionalitetit të tyre. Pikërisht referuar kësaj dispozite, por edhe në konsideratë të përcaktimeve të nenit 15 pika 4, shkronja “a” dhe të nenit 90 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, sipas pikës 2 të projektvendimit, janë përcaktuar 15 pozicione të lira që i korrespondon numrit të gjyqtarëve të emëruar më datë 9 janar të vitit 2020 por që mban në konsideratë dhe pozicionet e lira në tërësi në sistemin gjyqësor në gjykatat e shkallës së parë më juridiksion të përgjithshëm dhe atë administrativ në kuptimin e plotësimit pikërisht të atyre pozicioneve që paraqesin nevojë urgjente në pikëpamje të funksionalitetit aktual të tyre, por edhe në një të ardhme të afërt referuar projeksioneve për mbarëvajtjen e sistemit të drejtësisë.

Në pikën 3 të projektvendimit parashikohet e drejta e të emëruarve referuar pikës 3 të nenit 35 si dhe pikave 3 dhe 4 të nenit 36 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” për të përcaktuar sipas renditjes preferenciale tre gjykata nga ato sipas pikës 2 të projektvendimit në të cilat ata kërkojnë të caktohen.

Në pikën 4 të projektvendimit parashikohet detyrimi i të emëruarve referuar nenit 8 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për deklarimin e situatës së papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3 të kësaj dispozite ligjore.

Më tej në pikën 5 të projektvendimit parashikohet afati i aplikimit nga të emëruarit, afat ky që është përcaktuar 7 ditë (1 javë) që vlerësohet i mjaftueshëm për të paraqitur ata preferencat e tyre. Në këtë pikë të projektvendimit është përcaktuar edhe se mungesa e aplikimit, pra mungesa e paraqitjes së preferencave nga të emëruarit nuk passjell ndalimin e procedurës së caktimit të tyre në pozicion. Për këtë përcaktim sikundër edhe sa i përket afatit të aplikimit është mbajtur parasysh se të emëruarit në rastin konkret për shkak të mosemërimit dhe caktimit në pozicion brenda muajit korrik të vitit kur ata janë diplomuar sipas nenit 39, pikat 1 dhe 2 të Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë iniciuar një proces gjyqësor përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në përfundim të të cilit me vendimin nr.4201, datë 12.12.2019 Këshilli është detyruar të dëmshpërblejë ata për periudhën deri në emërimin dhe caktimin e tyre në pozicion. Pra të emëruarit në rastin konkret përmes inicimit të këtij procesi gjyqësor de facto kanë kërkuar emërimin dhe caktimin e tyre në pozicion në vitin kur janë diplomuar domethënë jo në vitin pasues sikurse i jep të drejtë pika 2 e nenit 35 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në pikën 6 të projektvendimit përcaktohen dokumentet që të emëruarit duhet të dorëzojnë në momentin e aplikimit, konkretisht një deklaratë me shkrim ku përcaktohen sipas renditjes preferenciale tre gjykata nga ato sipas pikës 2 të këtij vendimi në të cilat kërkon të caktohet; b) një vetëdeklarim me shkrim sipas shtojcës së këtij vendimi ku të deklarohet nëse ndodhen apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale, sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Së fundmi në projektvendim parashikohet hyrja në fuqi e vendimit, konkretisht se vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, përpara se të kalojmë në votim, kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin? Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni.



**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Shpalljen e pozicioneve të lira për të diplomuarit në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019 dhe të emëruar gjyqtarë më datë 09.01.2020.

Pozicionet e lira janë si më poshtë:

- a) dy pozicione në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë;
- b) dy pozicione në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë;
- c) dy pozicione në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër;
- ç) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat;
- d) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër;
- dh) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier;
- e) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë;
- ë) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë;
- f) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës;
- g) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec;
- gj) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë;
- h) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Të emëruarit sipas pikës 1 të këtij vendimi kanë të drejtë të përcaktojnë, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2 të këtij vendimi, në të cilat ata kërkojnë të caktohen.

Të emëruarit sipas pikës 1 të këtij vendimi kanë detyrimin të deklarojnë situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Afati i aplikimit është deri më datë 21.01.2020. Mungesa e aplikimit nuk passjell ndalimin e procedurës së caktimit në pozicion të të emëruarve.

Në momentin e aplikimit të emëruarit sipas pikës 1 të këtij vendimi duhet të dorëzojnë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor këto dokumente:

Një deklaratë me shkrim ku përcakton, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2 të këtij vendimi, në të cilat kërkon të caktohet.

Një vetëdeklarim me shkrim, sipas Shtojcës së këtij vendimi, ku të deklarojë nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Atëherë, nëse keni ndonjë gjë tjetër?

Atëherë, e konsideroj mbledhjen të mbyllur.

Faleminderit, për prezencën.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**